



Njoftim për Ruajtjen e Fshehtësisë nga Korporata e Spitaleve dhe e Shëndetit në qytetin e New York-ut

Ky njoftim përshkruan si mund të përdoret e të bëhet i ditur informacioni mjekësor që kemi për ju dhe si mund ta dispononi ju vetë atë informacion. Ju lutemi lexojeni me vëmendje.

Ky Njoftim për Ruajtjen e Fshehtësisë përshkruan llojin e informacionit që Korporata e Spitaleve dhe e Shëndetit në qytetin e New York-ut ("NYCHHC") mbledh në lidhje me ju; kujt mund t'i jepet ky informacion dhe ç'garanci ekzistojnë për mbrojtjen e tij. Ky njoftim gjithashtu përshkruan të drejtat tuaja për ta disponuar këtë informacion dhe për ta korrigjuar në qoftë se përmban gabime. Në rast se praktikatat e përshkruara këtu janë ashtu siç i prisnit, nuk ka nevojë të bëni asgjë. Në rast se ju dëshironi që këto informacione mos t'ia japim kujt, kërkesën tuaj me shkrim mund t'jua plotësojmë, siç tregohet në vijim. Në rast se kenë ndonjë pyetje në lidhje me këtë Njoftim për Ruajtjen e Fshehtësisë, mund të lidheni me Funksonarin tonë të Fshehtësisë në Korporatë, (Corporate Privacy Officer) duke i dërguar postë elektronike në CPO@NYCHHC.org ose duke i telefonuar gratis në numrin **1-866-HELP-HHC**.

Me kë ka të bëjë ky njoftim?

Ky njoftim përshkruan praktikatat e NYCHHC dhe ato të:

- Cilitdo punonjës profesionist shëndetësor që është i autorizuar të regjistrojë informacion në kartelën tuaj klinike
- Të gjitha departamenteve dhe njërive të NYCHHC, spitaleve, klinikave dhe mjekëve të komunitetit, si dhe filialeve që ofrojnë, për llogari të NYCHHC, shërbim shëndetësor në institucionet e NYCHHC
- Cilitdo punonjës të NYCHHC (duke përfshirë personelin, vullnetarët, studentët dhe personelin tjetër të NYCHHC)

Të gjitha këto ente dhe institucione janë të detyruara të ndjekin udhëzimet e këtij njoftimi. Veç kësaj, individët, entet dhe institucionet e mësipërme mund t'ia japin informacionin mjekësor njëri-tjetrit, për qëllime të trajtimit mjekësor, pagesës, shërbimeve të tjera shëndetësore ose veprimtarive kërkimore-shkencore, siç përshkruhet në këtë njoftim.

Zotimi ynë për informacionin tuaj mjekësor

E kuptojmë se informacioni që zotërojmë për ju dhe për shëndetin tuaj ka karakter personal, prandaj edhe zotohemi të mbrojmë fshehtësinë e tij. Është në vetë natyrën e punës sonë që të krijojmë dokumentacion për trajtimin mjekësor dhe shërbimet që ju bëhen. Ky dokumentacion na duhet për

t'ju siguruar shërbim cilësor si dhe për të përmbushur disa kërkesa ligjore të caktuara. Ky njoftim ka të bëjë me të gjithë dokumentacionin që krijohet nga NYCHHC në lidhje me shërbimin mjekësor, pavarësisht nëse vjen prej mjekut tuaj personal, apo nga ndonjë punonjës tjetër i NYCHHC.

Sa herë që e përdorim termin “informacion mjekësor” në këtë njoftim, kemi parasysh atë informacion që NYCHHC ka krijuar apo ka marrë për ju dhe që lidhet me shërbimet shëndetësore që ju janë bërë, si dhe me pagesën e këtyre shërbimeve.

Ky njoftim ju tregon edhe se në ç'rrethana mund ta përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve informacionin që kemi për ju. Gjithashtu përshkruajmë këtu të drejtat tuaja dhe disa detyrime tonat ndaj përdorimit dhe bërjes të ditur të informacionit mjekësor.

Ligji federal na kërkon:

- Të garantojmë fshehtësinë e informacionit tuaj mjekësor
- T'ju bëjmë të njohur, me anë të këtij njoftimi, detyrimet tona ligjore dhe praktikrat që ndjekim për të ruajtur fshehtësinë e informacionit tuaj mjekësor
- Të ndjekim dispozitat e njoftimit për ruajtjen e fshehtësisë aktualisht në fuqi

Kur mund ta përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve informacionin mjekësor që kemi për ju

Më poshtë do të përshkruajmë mënyra të ndryshme si mund ta përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve informacionin tuaj mjekësor. Për çdo rast të veçantë do të shpjegojmë se për çfarë e kemi fjalën dhe do të japim shembuj. Këta shembuj nuk janë të vetmit.

Për trajtim mjekësor. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund ta përdorim për t'ju siguruar trajtim mjekësor ose shërbim shëndetësor. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ua bëjmë të ditur mjekëve, infermiereve, teknikëve, studentëve të mjekësisë ose punonjësve të tjerë që kujdesen për ju në NYCHHC. Për shembull: një mjek që kujdeset për këmbën që keni thyer mund të duhet të dijë nëse keni diabet apo jo, sepse diabeti mund ta ngadalësojë procesin e shërimit. Veç kësaj, nëse keni diabet duhet të njoftohet edhe specialisti dietolog, në mënyrë që t'ju sigurohet ushqim i përshtatshëm. Edhe departamentet e ndryshme të institucionit ku gjendeni mund të duhet t'i komunikojnë njëri-tjetrit informacion mjekësor për ju, për të bashkërenduar shërbimet që ju bëhen, të tilla si recetat, analizat laboratorike e radiografite. Kur është e nevojshme, informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ua bëjmë të ditur edhe punonjësve jo të institucionit, por që kanë lidhje me trajtimin mjekësor që po ju bëhet.

Për pagesat. Informacioni mjekësor që kemi për ju do të përdoret, sipas nevojës, për të marrë pagesat e shërbimeve shëndetësore që ju janë bërë. Për shembull, mund të na duhet t'i japim planit tuaj shëndetësor informacion për një ndërhyrje kirurgjikale tuajën në NYCHHC, në mënyrë që plani juaj shëndetësor të na paguajë ne, ose t'ju rimbursojë për atë që keni paguar për operacionin. Gjithashtu mund ta njoftojmë planin tuaj shëndetësor për një trajtim që do t'ju ofrohet, për të marrë miratim paraprak ose për të sqaruar nëse plani juaj është i gatshëm ta mbulojë këtë trajtim.

Për shërbime shëndetësore. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund ta përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve sipas nevojave të administrimit të përditshëm të NYCHHC dhe

për t'u siguruar të sëmurëve shërbime shëndetësore cilësore. Për shembull, mund ta përdorim informacionin mjekësor për të kontrolluar cilësinë e trajtimit mjekësor dhe të shërbimeve si dhe për të vlerësuar rendimentin e personelit që ju kemi vënë në shërbim. Gjithashtu mund të kombinojmë informacion mjekësor që kemi për shumë pacientë, për të vendosur se çfarë shërbimesh të tjera duhet të ofrojë NYCHHC, çfarë shërbimesh janë të tepërta nga ato që ofrohen si dhe për të kontrolluar efikasitetin e shërbimeve të caktuara. Po të jetë nevoja, informacionin mjekësor mund t'ua bëjmë të ditur edhe llogaritarëve, konsulentëve dhe profesionistëve të tjerë që na ndihmojnë për të administruar institucionin.

Përkujtesa vizitash mjekësore. Informacionin mjekësor mund ta përdorim dhe t'ua bëjmë të ditur të tjerëve për t'ju kujtuar ditën dhe orën e një takimi me mjekun a një vizite mjekësore në institucionin.

Variante alternative të trajtimit. Informacionin mjekësor mund ta përdorim dhe t'ua bëjmë të ditur të tjerëve për t'ju treguar disa alternativa të trajtimit mjekësor që mund t'ju interesojnë.

Shërbime dhe kompensime të lidhura me kujdesin shëndetësor. Informacionin mjekësor mund ta përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve për t'ju njoftuar në lidhje me shërbime, kompensime dhe veprimtari të ndryshme të lidhura me kujdesin shëndetësor, që mund t'ju interesojnë.

Veprimtari për mbledhje fondesh. Emrin tuaj, adresën, datat kur u kuroat, moshën dhe të dhëna të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me sëmundjen tuaj mund t'i përdorim për t'u lidhur me ju dhe për t'ju kërkuar të mbështetni financiarisht institucionet tona dhe veprimtaritë e tyre shëndetësore. Të dhënat e mësipërme mund t'ia bëjmë të ditura edhe ndonjë fondacioni të lidhur me NYCHHC, për të njëjtat qëllime. Nëse dëshironi që të mos kontaktojmë me ju për këto përpjekje për mbledhje fondesh, mund t'ia kërkonit këtë Funksonarit tonë të Fshehtësisë në Korporatë (Corporate Privacy Officer) duke i dërguar postë elektronike në adresën CPO@NYCHHC.org ose duke i telefonuar numrit **1-866-HELP-HHC**.

Regjistri i institucionit. Me përjashtim të rastit kur ju vetë keni shprehur mospëlqim, mund të përfshijmë disa të dhëna mjekësore që kemi për ju në regjistrin e të sëmurëve të shtruar, për sa kohë ju gjendeni i shtruar në spital. Këto të dhëna mund të përfshijnë emrin tuaj, dhomën ku ndodheni në institucion, gjendjen tuaj të përgjithshme (për shembull: e mirë, e stabilizuar, etj.) dhe përkatësinë tuaj fetare. Informacionet e mësipërme, me përjashtim të përkatësisë fetare, mund t'u komunikohen personave nga publiku që pyesin për ju me emër. Përkatësia fetare, përkundrazi, do t'u komunikohet vetëm klerikëve. Nëse dëshironi që disa prej këtyre të dhënave ose edhe të gjitha të mos përfshihen në regjistrin e institucionit, duhet të njoftoni Drejtorin e Pranimeve (Director of Admitting) të institucionit.

Personat që kujdesen për ju ose që paguajnë për kujdesin tuaj shëndetësor. Me përjashtim të rastit kur ju vetë keni shprehur mospëlqim, informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ia bëjmë të ditur një të afërm, miku ose anëtari të familjes suaj që është i përfshirë në kujdesin shëndetësor për ju. Këtë informacion mund t'ia japim edhe dikujt që ndihmon për të paguar shërbimet shëndetësore që ju bëhen. Ne gjithashtu mund të njoftojmë familjen tuaj ose të afërmit e miqtë për sëmundjen tuaj dhe që jeni i shtruar në spital. Veç kësaj, informacionin mjekësor për ju mund t'ia komunikojmë edhe një enti që po ofron ndihmë pas një katastrofe, në mënyrë që familja juaj të njoftohet për gjendjen tuaj, shëndetin dhe vendin ku ndodheni.

Personat që veprojnë në emrin tuaj. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ia komunikojmë një përfaqësuesit tuaj personal, një prindi ose një kujdestari. Ju keni të drejtën të emëroni një përfaqësues personal që të veprojë në emrin tuaj, për të kontrolluar ruajtjen e fshehtësisë së informacionit tuaj mjekësor. Prindërit dhe kujdestarët, në përgjithësi, kanë të drejtë të kontrollojnë ruajtjen e fshehtësisë së informacionit shëndetësor për të miturit, me përjashtim të rastit kur të miturve u është lejuar me ligj të përfaqësojnë vetveten.

Kërkimet shkencore. Në rast se ju merrni pjesë në një sprovë klinike, do t'ju kërkojmë leje me shkrim para se të përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve informacionin tuaj mjekësor. Në disa rrethana, informacionin tuaj mjekësor mund ta përdorim për qëllime të një studimi shkencor pa lejen tuaj me shkrim pas një procesi të veçantë miratimi që garanton rrezik minimal për fshehtësinë e këtij informacioni. Në asnjë rast nuk do të lejohet që një studiues të bëjë të njohur publikisht emrin tuaj ose identitetin tuaj, gjatë kohës që po përgatitet për një studim shkencor, ose gjatë tij apo pas përfundimit të tij.

Nëse ju vendosni të merrni pjesë në një sprovë klinike, mund t'ju kërkojmë të pezulloni shqyrtimin e asaj pjese të informacionit tuaj mjekësor që lidhet me studimin; këtë pjesë të informacionit do të mund ta dispononi pasi të ketë përfunduar prova.

Kur e kërkon ligji. Informacionin mjekësor që kemi për ju do t'ua bëjmë të ditur të tjerëve sa herë e kërkon ligji federal, shtetëror ose vendor.

Për të shmangur ndonjë kërcënim serioz për shëndetin ose sigurinë. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund ta përdorim ose t'ua bëjmë të ditur të tjerëve, kur është e nevojshme, për të shmangur ndonjë kërcënim serioz për shëndetin dhe sigurinë tuaj ose të publikut ose të një personi tjetër.

Rrethana të veçanta kur fshehtësia nuk mund të ruhet

Ushtarakët dhe veteranët. Në rast se ju jeni anëtar i forcave të armatosura, informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ua bëjmë të ditur të tjerëve nëse kjo kërkohet nga autoritete të komandës ushtarake.

Kompensimi i Punonjësve (Workers' Compensation). Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ia bëjmë të ditur programit të Kompensimit të Punonjësve ose programeve të tjera të ngjashme.

Veprimtari të shëndetit publik. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ua bëjmë të ditur, për qëllime të shëndetit publik, organizatave qeveritare që janë të autorizuar të parandalojnë përhapjen e sëmundjeve ose për të marrë raportime në lidhje me gjendje shëndetësore të caktuara, lindje fëmijësh, vdekje, abuzime, braktisje dhe dhunë shtëpiake. Para se ta komunikojmë këtë informacion, do të përpiqemi të marrim leje prej jush, me përjashtim të rasteve kur jemi të autorizuar ose kur na kërkohet të veprojmë ashtu pa lejen tuaj.

Mbrojtje të posaçme për informacione mbi HIV, përdorimin abuziv të alkoolit dhe drogave, sëmundjet mendore dhe të dhënat gjenetike. Fshehtësia e informacioneve që lidhen me HIV, trajtimin e përdorimit abuziv të alkoolit dhe drogave, sëmundjet mendore dhe të dhënat me natyrë gjenetike, ruhet me dispozita të posaçme. Në rast se gjendja juaj shëndetësore ka të bëjë me këto fusha të veçanta, ju lutemi lidhuni me ofruesit ose këshilltarët e shërbimeve shëndetësore, për të marrë të dhëna të mëtejshme në lidhje me këto mbrojtje shpesh.

Veprimtari të mbikqyrjes së shëndetit. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ia bëjmë të ditur një agjencie të mbikqyrjes shëndetësore për veprimtari të autorizuar me ligj. Këto veprimtari të mbikqyrjes mund të përfshijnë kontrolle, verifikime, inspekte dhe hetime të ndryshme.

Procedura ligjore. Në rast se jeni i përfshirë në një proces ose mosmarrëveshje gjyqësore, mund t'ua bëjmë të ditur të tjerëve informacionin mjekësor që kemi për ju, po të na kërkohet kjo me vendim gjyqi ose administrativ. Këtë informacion mjekësor gjithashtu mund t'ua bëjmë të ditur të tjerëve në përgjigje të një fletëthirrjeje gjyqësore, një kërkesë për informim ose një procedure tjetër ligjore të nisur nga një palë e tretë e përfshirë në këtë çështje, me kusht që të jenë bërë përpjekje për t'ju njoftuar ju në lidhje me këtë kërkesë, ose për të marrë nga gjykata një vendim për mbrojtjen e informacionit të kërkuar.

Ruajtja e rendit. Informacionin mjekësor mund t'ua bëjmë të ditur të tjerëve për qëllime të ruajtjes së rendit, çka përfshin sa më poshtë:

- Në përgjigje të procedurave ligjore
- Për të identifikuar ose gjetur një person të dyshuar a të arratisur, një dëshmitar material ose një person të zhdukur
- Në rrethana që kanë lidhje me viktimat e një krimi
- Në raste vdekjesh që ne besojmë se mund të jenë pasojë veprimtarie kriminale
- Në raste krimesh të konsumuara brenda institucionit
- Për të raportuar një krim në rast urgjence; ose vendin ku është kryer krimi a ku gjenden viktimat; ose identitetin, përshkrimin ose vendndodhjen e personit që e ka kryer krimin.

Hetuesit e vrasjeve, hetuesit mjeko-ligjorë, drejtorët e ndërmarrjeve funerale dhe entet e dhurimit të organeve. Mund t'i japim informacion mjekësor një hetuesi vrasjesh ose një hetuesi mjeko-ligjor. Gjithashtu, informacionin mjekësor për të shtruarit në institucion mund t'ua japim drejtorëve të ndërmarrjeve funerale, sipas nevojës, që këta të mund të kryejnë detyrën. Informacioni mjekësor mund të përdoret dhe të bëhet i ditur gjatë procedurave të dhurimit të organeve, syve dhe indeve trupore

Veprimtari që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe zbulimin. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ua bëjmë të ditur funksionarëve federalë të autorizuar, sa herë është fjala për veprimtari të zbulimit, kundërzbulimit dhe veprimtari të tjera të lidhura me sigurinë kombëtare të autorizuar me ligj.

Shërbime në mbrojtje të Presidentit dhe të tjerëve. Informacionin mjekësor që kemi për ju mund t'ua bëjmë të ditur funksionarëve federalë të autorizuar, që këta të mund t'i garantojnë sigurinë Presidentit, personave të tjerë të autorizuar, kryetarëve të shteteve dhe huaja, ose për të kryer hetime të posaçme.

Të burgosurit. Informacionin mjekësor që kemi për të burgosurit në një institucion korrektues mund t'ia bëjmë të ditur institucionit korrektues ose funksionarëve të ruajtjes së rendit, sa herë është e nevojshme që (1) t'u sigurohet shërbimi shëndetësor të burgosurve; (2) të mbrohet shëndeti dhe siguria e të burgosurve, ose shëndeti dhe siguria e të tjerëve; dhe (3) për të mbrojtur sigurinë e institucionit korrektues.

Të drejtat që ju keni për informacionin tuaj mjekësor

Në lidhje me informacionin mjekësor që kemi për ju, ju njihen të drejtat e mëposhtme:

E drejta për ta disponuar dhe për ta kopjuar. Ju jepet e drejta të kërkonti për të disponuar dhe kopjuar informacionin që mund të përdoret për të marrë vendime në lidhje me ju. Zakonisht këtu është fjala për dokumentacion mjekësor dhe të pagesave, por jo për shënime të seancave psikoterapeutike ose të dhëna që kanë të bëjnë me një sprovë klinike në vazhdim.

Për të parë dhe kopjuar informacionin që mund të përdoret për të marrë vendime për ju, dërgojini kërkesë me shkrim Departamentit të Administrimit të Informacionit Shëndetësor (Health Information Management Department) të institucionit. Nëse kërkonti një kopje të informacionit, mund t'ju duhet të paguani një tarifë, për të mbuluar shpenzimet e kopjimit, përgatitjes dhe postimit të materialeve. Në rast se kërkesa ju refuzohet, do t'ju shpjegohet pse. Keni të drejtë të kërkonti që refuzimi i kërkesës të rishikohet. Në këtë rast NYCHHC do të ngarkojë një tjetër profesionist të licensuar në fushën shëndetësore për të shqyrtuar kërkesën tuaj dhe shkaqet e refuzimit të saj. Ky person do të jetë i ndryshëm nga personi që jua refuzoi kërkesën. Ne do të respektojmë rezultatet e këtij rishikimi.

E drejta e korigjimit të gabimeve. Në rast se keni përshtypjen se informacioni mjekësor që kemi për ju është i pasaktë ose i paplotë, mund të kërkonti prej nesh që ta korigjojmë. Është e drejta juaj të kërkonti korigjime për sa kohë informacioni ruhet në institucion ose për llogari të tij. Kërkesën duhet t'ia parashtroni me shkrim Departamentit të Administrimit të Informacionit Shëndetësor (Health Information Management Department) të institucionit. Veç kësaj, duhet të paraqitni një arsye në mbështetje të kërkesës suaj. Kërkesën për korigjime ne mund t'jua refuzojmë në rast se ajo nuk është bërë me shkrim ose nuk përmban ndonjë arsye në mbështetje të kërkesës. Kërkesën mund ta refuzojmë edhe në rastin kur na kërkonti të korigjojmë informacion që:

- Nuk është krijuar prej nesh, me përjashtim të rastit kur na ofroni arsye për të besuar se personi që e krijoi atë informacion nuk është më në gjendje të ndërmarrë korigjimin e nevojshëm
- Nuk është pjesë e informacionit që mund të përdoret për të marrë vendime në lidhje me ju
- Nuk është pjesë e informacionit që ju jeni i lejuar të shqyrtoni dhe të kopjoni
- Është i përpiktë dhe i plotë

E drejta për një Listë të Komunikimeve (Accounting of Disclosures). Keni të drejtë të kërkonti një "Listë të Komunikimeve", e cila nuk është veçse një listë e të gjitha rasteve kur informacionin mjekësor që kemi për ju, ua kemi bërë të ditur të tjerëve. Në këtë listë nuk do të përfshihen ato raste kur informacionin e kemi komunikuar në kuadrin e trajtimit mjekësor që ju kemi bërë, ose për efekt pagese, ose gjatë procedurave të shërbimit shëndetësor të NYCHHC, ose kur ju vetë keni lejuar që kjo të ndodhë. Për ta kërkuar këtë listë, parashtroni një kërkesë me shkrim Departamentit të Administrimit të Informacionit Shëndetësor (Health Information Management Department) të institucionit. Kërkesa juaj duhet të kufizohet në një periudhë kohe jo më të gjatë se gjashtë vjet, dhe gjithsesi jo më parë datës 14 prill 2003. Në kërkesë gjithashtu duhet të tregoni se në ç'formë dëshironi t'ju vijë lista (d.m.th. në letër, apo në format elektronik). Lista e parë që kërkonti brenda një periudhe 12-mujore do t'ju jepet gratis. Nëse kërkonti lista të tjera, mund t'ju kërkojmë të paguani një shumë të caktuar, për të mbuluar

shpenzimet e sigurimit të informacionit. Do t'ju njoftojmë paraprakisht për sa duhet të paguani, në mënyrë që të mund të vendosni paraprakisht nëse do ta bëni kërkesën apo jo.

E drejta për të kërkuar kufizime. Keni të drejtën të kërkonti një kufizim në informacionin tuaj mjekësor që ne përdorim ose ua bëjmë të ditur të tjerëve, për qëllime të trajtimit mjekësor, pagesës ose shërbimit shëndetësor. Keni gjithashtu të drejtën të kërkonti vendosjen e disa kufizimeve në informacionin mjekësor për ju që ia bëjmë të ditur një personi i cili kujdeset për ju, për shembull një pjesëtar të familjes ose një shoku. Mund të kërkonti, për shembull, që të mos përdorim as të bëjmë të ditur të tjerëve informacion për një procedurë mjekësore së cilës i jeni nënshtruar.

Nuk jemi të detyruar t'ju përmbushim kërkesën. Megjithatë, në rast se biem dakord me ju, do t'ju plotësojmë, me përjashtim të rastit kur informacioni në fjalë është i nevojshëm për t'ju siguruar shërbim mjekësor në rast urgjence. Për të kërkuar vendosje kufizimesh, parashtrojini një kërkesë me shkrim Drejtorit të Pranimeve (Director of Admitting) ose Drejtorit të Regjistrimeve (Director of Registration) të institucionit. Në kërkesën tuaj na sqaroni:

- Çfarë informacioni dëshironi të kufizoni
- Nëse dëshironi të kufizoni përdorimin prej nesh, bërjën të ditur të tjerëve, apo të dyja
- Ndaj kujt do të zbatohen këto kufizime (për shembull, ndaj bashkëshortes suaj)

E drejta për të kërkuar fshehtësi në komunikim. Keni të drejtën të kërkonti që të komunikojmë me ju, për sa u përket çështjeve mjekësore, vetëm në një mënyrë e në një vend të caktuar. Për shembull, mund të na kërkonti që t'ju kontaktojmë vetëm në vendin e punës ose me postë. Për të kërkuar fshehtësi komunikimi, parashtrojini një kërkesë me shkrim Njesisë së Letërkëmbimit Mjekësor (Medical Correspondence Unit) të institucionit. Nuk do t'ju pyesim për shkaqet që ju shtojnë ta kërkonti këtë. Të gjitha kërkesat e arsyeshme do të pranohen. Në kërkesë duhet të saktësoni mirë se si dhe ku dëshironi që t'ju kontaktojmë.

E drejta për të marrë një kopje në letër të këtij njoftimi. Keni të drejtën të kërkonti një kopje në letër të këtij njoftimi në çdo kohë. Edhe në rast se njoftimi ju ka mbërritur në format elektronik, mund të kërkonti gjithnjë një kopje në letër. Një kopje të njoftimit mund ta gjeni edhe në selinë tonë në Internet, www.NYCHHC.org. Për të marrë një kopje në letër të këtij njoftimi, drejtoju Departamentit të Pranimeve (Admitting Department) ose Departamentit të Regjistrimit (Registration Department) të institucionit.

Ndryshimet e këtij njoftimi

Rezervojmë të drejtën t'i bëjmë ndryshime këtij njoftimi. Gjithashtu rezervojmë të drejtën që këto ndryshime t'i vëmë në zbatim për informacion mjekësor që tanimë e kemi për ju, si dhe për çfarëdo informacioni mjekësor që do të marrim në të ardhmen. Një kopje e njoftimit do të afishohet gjithnjë në institucion. Njoftimi do të përmbajë, në cepin lart djathtas të faqes së parë, datën e hyrjes në fuqi.

Ankesa

Nëse besoni se ju janë shkelur të drejtat për ruajtjen e fshehtësisë, mund të parashtroni një ankesë pranë NYCHHC ose Sekretarit të Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore dhe Humanitare (Department of Health and Human Services). Për të parashtruar një kërkesë pranë NYCHHC, merrni në telefon linjën gratis direkte të ankesave në **1-866-HELP-HHC**, ose dërgoni postë elektronike në adresën CPO@NYCHHC.org.

Nuk do të merret asnjë masë ndaj jush për paraqitjen e një anese.

Përdorime të tjera të informacionit mjekësor

Përdorime dhe komunikime të informacionit mjekësor që nuk përmenden në këtë njoftim ose në ligjet e zbatueshme ndaj nesh mund të bëhen vetëm me lejen tuaj me shkrim. Edhe nëse ju na lejoni të përdorim ose të bëjmë të ditur informacionin mjekësor që kemi për ju, gjithnjë mund të ndërtoni mendje dhe ta shfuqizoni këtë leje, me shkrim, në çdo kohë.

Në rast se e shfuqizoni lejen, ne nuk do ta përdorim apo do ta bëjmë të ditur informacionin që kemi për ju, në ato rrethana që lidheshin me autorizimin tuaj me shkrim. Megjithatë, nuk do të mund të kthejmë mbrapsht ato deklaramë që i kemi bërë me lejen tuaj dhe që jemi të detyruar t'i ruajmë si dokumentacion të shërbimeve shëndetësore që ju kemi ofruar.

Pranim

Duke nënshkruar dhe vendosur datën në formularin e mëposhtëm, unë pranoj se kam marrë një kopje të Njoftimit për Ruajtjen e Fshehtësisë nga Korporata e Spitaleve dhe e Shëndetit në qytetin e New York-ut.

Emri i pacientit
(Patient's Name)

Numri i kartelës klinike të pacientit
(Patient's Medical Record Number)

Nënshkrimi i pacientit
(Patient's Signature)

Data e sotme
(Today's Date)

Nëse këto veprime po i kryen një përfaqësues personal i pacientit, shkruani emrin tuaj në hapësirën më poshtë (If executed by a patient's personal representative, please print your name in the space below):

Emri i përfaqësuesit personal
(Personal Representative's Name)

Nënshkrimi i përfaqësuesit personal
(Personal Representative's Signature)

PËR PËRDORIM VETËM NGA PERSONELI I NYCHHC

(FOR USE BY NYCHHC STAFF ONLY):

Patient refused to sign

Patient unable to sign

NYCHHC Employee's Initials

Today's Date